



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT
SEKTORI I ASISTENCËS DHE SHËRBIMIT

Nr.8072/1 Prot.

Tiranë, më 27.04.2019

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. BLERINA HOXHA
REVISTA MONITOR
Rr. "Ismail Qemali", Nr.32

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 17.04.2019, të protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr. 8072 Prot., datë 17.04.2019, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 121, me lëndë: "Kërkesë zyrtare për Informim", pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit të sipërcituar, ju informojmë sa më poshtë vijon:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2018 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar nenet 24 dhe 25, si dhe pikat referuese të Udhëzimit 24, datë 02.09.2008, të Ministrisë të Financave dalë në zbatim të tij, përcaktojnë saktësisht autoritetet dhe rrethanat në të cilat Administrata Tatimore, mund dhe duhet të ofrojë pas kërkesës me shkrim, informacion tatimor të administruar prej saj, në lidhje me tatimpaguesit. Detyrimi ligjor për të ruajtur kofidencialitetin e të dhënave të administruara është parashikuar saktësisht edhe nga neni 31, i ligjit të sipërcituar, i cili thekson se: "çdo tatimpagues ka të drejtën e kofidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga Administrata Tatimore".

Administrata Tatimore, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, është një institucion ekzekutues dhe zbatues dhe që udhëhiqet nga parimi për zbatimin e njëjtë dhe efektiv të

legjislacionit për të gjithë tatimpaguesit, parashikuar shprehimisht nga neni 12/a) i Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar, pavarësisht nëse subjektet për të cilat kërkohet informacioni janë entitete publike apo private.

Bazuar në sa më sipër, ju dërgojmë në format elektronik listën e bashkive (dhe komunave), të cilat kanë detyrime të papaguara, si dhe listën e enteve shtetërore të cilat kanë detyrime të papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe shëndetësore.

ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Xhavit Çurri

